RAPORT I DEPARTAMENTIT TE SHTETIT TE SHB.A.
MBI TE DREJTAT E NJERIUT

SHQIPËRIA 2004

Shqipëria është një republikë me një parlament shumëpartiak, dhe një Kryeministër e një President, të dy të zgjedhur nga Parlamenti. Kryeministri kryeson Qeverinë; Presidenca është një post kryesisht ceremonial me fuqi të kufizuar ekzekutive. Në vitin 2003, në mbarë vendin u zhvilluan zgjedhje vendore, të cilat u gjykuan si një përmirësim në krahasim me zgjedhje të mëparshme, dhe ku pati vetëm pak incidente të izoluara parregullsish dhe dhune. Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur; megjithatë, korrupsioni dhe presioni politik kufizuan aftësinë e tij për të funksionuar në mënyrë të pavarur dhe të efektshme.

Njësitë vendore të policisë që varen nga Ministria e Rendit Publik, janë përgjegjëse kryesisht për sigurinë e brendshme. Ushtria ka një njësi speciale "komando" prej 151 pjesëtarësh, e cila ka rolin anti-terror dhe është nën varësinë e Ministrit të Mbrojtjes. Gjatë kohërave të krizave të brendshme, ligji e lejon Ministrin e Rendit Publik të kërkojë të ketë autoritet mbi këtë njësi. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) është përgjegjës si për mbledhjen e informacionit të zbulimit të brendshëm dhe të jashtëm ashtu edhe për kundërzbulimin. Autoritetet civile përgjithësisht ruajtën kontroll të efektshëm mbi forcat e sigurisë. Disa anëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime të të drejtave të njeriut.

Vendi pati një ekonomi mikse e cila ishte në tranzicion nga planifikimi i centralizuar ekonomik në një sistem të tregut të lirë. Vendi vazhdoi të përjetonte progres ekonomik të ngadaltë por të qëndrueshëm; ekonomia u rrit me 6 përqind. Megjithatë, afro 25 përqind e popullsisë së vendit prej afërsisht 3.1 milionë banorësh jetonin nën kufirin e varfërisë. Sipas Qeverisë, niveli i papunësisë ishte 15.2 përqind; megjithatë, disa raporte jozyrtare e cilësojnë deri 22 përqind. Inflacioni mesatar ishte 3.2 përqind dhe pagat e sektorit buxhetor u rritën me 10 përqind.

Qeveria në përgjithësi respektoi të drejtat e njeriut të qytetarëve të saj; megjithatë, pati probleme serioze në një numër fushash. Policia rrahu dhe abuzoi të dyshuarit, të ndaluarit dhe të burgosurit. Kushtet e burgjeve mbetën të këqija. Policia në disa raste arrestoi dhe ndaloi arbitrarisht, dhe ndalimi i zgjatur para gjyqit ishte një problem. Mosndëshkimi i zyrtarëve ishte një problem. Qeveria me raste shkeli të drejtat e qytetarëve për intimitet. Ndërhyrja politike në media ndodhi më rrallë se sa në vite të mëparshme. Policia sipas raportimeve përdori forcë të tepërt kundër protestuesve. Veprimet e eleminimit të individëve, kryesisht të lidhura me gjakmarrjet tradicionale, rezultuan në disa vrasje dhe një atmosferë frike në disa zona të vendit. Dhuna dhe diskriminimi shoqëror kundër grave dhe fëmijëve ishin probleme serioze. Diskriminimi shoqëror kundër romëve, komunitetit egjiptian dhe homoseksualëve vazhdoi. Puna e fëmijëve ishte problem. Trafikimi i personave mbeti një problem, për trajtimin e të cilit qeveria ndërmori disa hapa.

RESPEKTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Seksioni 1 Respekti për Integritetin e Personit, Përfshi Lirinë Nga:

a. Privimi Arbitrar apo i Jashtëligjshëm i Jetës

Nuk pati vrasje politike; megjithatë, forcat e sigurisë vranë një person gjatë vitit.

Në korrik, Erigert Ceka, një minoren 17-vjeçar, vdiq si rezultat i rrahjes nga policia gjatë kohës që ishte në paraburgim. Si rezultat i vdekjes, prokuroria filloi ndjekjen penale kundër dy rojeve të policisë që u akuzuan për kryerje të "veprimeve arbitrare." Në nëntor, një nga rojet u dënua me 6 muaj burg për kryerje të veprimeve arbitrare në shkelje të ligjit gjatë shoqërimit të të paraburgosurve, dhe në dhjetor, roja tjetër i policisë u dënua me 8 muaj burg për shkelje të rregullave të shërbimit të rojës sipas kodit ushtarak dhe abuzim të detyrës. Çështjet ishin apeluar në fund të vitit; megjithatë, gjykata nuk bëri ndokënd përgjegjës për vdekjen e Cekës.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati vdekje të raportuara për shkak të minave tokësore. Megjithatë, pati gjashtë vdekje nga aksidente të lidhura me minat që përfshijnë një bombë në një mjedis trainimi që vrau dy dhe plagosi disa individë, si dhe një minë antitank që vrau katër të tjerë, tre prej të cilëve ishin fëmijë.

Vendi vazhdoi të përjetonte nivele të larta krimi të dhunshëm. Shumë vrasje vazhduan të ndodhnin në mbarë vendin si rezultat i veprimeve individuale apo klanore hakmarrëse të lidhura me "gjakmarrjet" tradicionale apo konflikteve mes bandave kriminale. Sipas Ministrisë së Rendit Publik, të paktën 10 individë u vranë gjatë vitit nga gjakmarrjet, të cilat bazohen në Kodin mesjetar të Lek Dukagjinit ("Kanuni"), i cili u praktikua nga individë sidomos në pjesën veriore të vendit. Sipas Kanunit, vetëm meshkujt e rritur janë shënjestra të pranueshme për gjakmarrje; megjithatë, gratë apo fëmijët shpesh u vranë apo plagosën në sulme. Si reszultat i gjakmarrjes, gjatë vitit, 670 familje u vetë-burgosën, 650 familje pranuan procedura ligjore në vend të hakmarrjeve personale për zgjidhjen e konfliktit, dhe 54 familje jetonin nën mbrojtje jashtë vendit; 160 fëmijë u ndaluan të ndiqnin shkollën nga frika e hakmarrjes, nga të cilët 73 gjykoheshin të ishin në rrezik serioz.

Kjo paraqiste rënie në krahasim me vitin 2003 kur vlerësohej se kishte 1,370 familje të vetë-burgosura në shtëpi dhe 711 fëmijë të parandaluar të ndiqnin shkollën nga frika e hakmarrjes. Konflikte për shkak të pronës dhe çështje të lidhura me trafikimin e njerëzve mbetën arsyet kryesore që i detyronin familjet të hynin në gjakmarrje. Në gusht, Emin Spahija, kreu i Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) Lidhja e Misionarëve të Paqes që punonte ekskluzivisht mbi çështje të gjakmarrjes, u vra pranë shtëpisë së tij në qytetin e Shkodrës. Policia nuk ka kapur ndonjë të dyshuar për vrasjen.

Rastet e gjakmarrjeve gjykoheshin në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Për çështje të vrasjeve për gjakmarrje ka dënime pre 20 vjet burgim ose burgim të përjetshëm. Megjithëse nuk kishte të dhëna për nivelin e ndjekjeve të gjakmarrjeve, vlerësimet tregonin se 60 deri 65 përqind e të gjitha rasteve silleshin në gjykatë dhe afërsisht të gjitha përfundonin në shkallën e apelit.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje për motive politike.

Tri ish-zyrtarë të SHISH, të cilët ishin arrestuar në vitin 2003 në lidhje me rrëmbimin e Ziso Kristopulli dhe Remzi Hoxha në vitin 1995, u liruan (njëri në vitin 2003 dhe dy në maj) për mungesë provash dhe çështja u pezullua. Megjithëse Kristopulli në fund u lirua, vendndodhja e Hoxhës mbeti e panjohur.

Grupe të të drejtave të njeriut, përfshi Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ), kanë ngritur pikëpyetje mbi lirimin e zyrtarëve të SHISH dhe pezullimin e çështjes së zhdukjes. Në nëntor, OJQ-të organizuan një konferencë shtypi dhe Amnesty International i shkroi një letër Kryeministrit duke kërkuar që çështja të rihapej. Deri më tani nuk janë ndërmarrë veprime.

c. Tortura dhe Trajtime apo Ndëshkime të Tjera të Egra, Çnjerëzore apo Poshtëruese

Kushtetuta i ndalon veprime të tilla; megjithatë, hera herës policia rrahu dhe torturoi persona të dyshuar. KSHH dhe GSHDNJ vazhduan të raportonin që forcat e policisë në mbarë vendin përdornin torturën dhe trajtimin çnjerëzor apo të tepruar; megjithatë, të dyja vunë në dukje që numri i këtyre rasteve kishte zbritur gjatë vitit. Sipas GSHDNJ, shumica e keqtrajtimit ndodhte në kohën e arrestimit apo të ndalimit fillestar. Romët dhe anëtarë të komunitetit egjyptian ishin veçanërisht të prekshëm nga abuzimi i policisë (shih Seksioni 5).

Në shkurt, sipas GSHDNJ, Niko Puriqi akuzoi Shefin e Policisë Kriminale të Përmetit se e kishte rrahur gjatë qëndrimit në paraburgim. Kontrollori mjekësor i policisë i verifikoi pretendimet e Puriqit. Në fillim Puriqi ishte akuzuar për vjedhje, megjithëse më pas policia i rrëzoi akuzat. Në mars, Shefi i Policisë Kriminale mori një paralajmërim.

Në tetor, Stathi Lako, një burrë 31-vjeçar nga Korça, u ndalua dhe pretendohet se u keqtrajtua gjatë ndalimit në paraburgim nga tri oficerë policie dhe Shefi i Zyrës së Krimeve të Rënda, Bajram Hyka. Sipas KSHH, arsyeja për ndalimin kishte qenë marrëdhënia e Lakos me të bijën e Hykës. Prokuroria ende nuk ka filluar ndonjë hetim të çështjes.

Në qershor, Beqir Kaba paraqiti një ankesë bazuar mbi pretendime për arrestim të jashtëligjshëm dhe keqtrajtim nga dy oficerë policie të komisariatit të policisë së Dibrës. Pas një ndërhyrjeje të Zyrës së Avokatit të Popullit, dy oficerët e policisë u pezulluan përkohësisht nga puna.

Në dhjetor 2003, hetimi për rrahjen e Behar Dedollit nga policia iu përcoll policisë ushtarake dhe më pas u pezullua për shkak të mungesës së provave.

Në vitin 2003, Romeno Nexhipi pretendoi që policia e Fierit e pati rrahur pasi i kishin kërkuar t'i shoqëronte në komisariatin e policisë. Ai u dërgua në spital për trajtim dhe më pas u çua në komisariatin e policisë ku u mbajt gjatë natës. Nexhipi më pas u akuzua me prishje të qetësisë publike dhe për sulm ndaj një oficeri policie; megjithatë, në fund të vitit, çështja ishte pezulluar.

Alnor Hasa, ish Shef i Policisë Kriminale akuzuar për rrahjen e një të ndaluari në vitin 2002, u dënua me 2 vjet burg.

Nuk pati zhvillime në çështjen e sulmit të Pergjinit të Prillit 2002, ku pretendohej që tri vëllezër u arrestuan dhe u rrahën nga policia si ndëshkim për një sherr me oficerët e policisë. Çështja e sulmit të vitit 2002 ndaj Azgan Haklajt, në të cilën u paraqitën akuza kundër katër oficerëve të policisë akuzuar për sulm ndaj Haklajt gjatë arrestimit të tij në vitin 2001, u pezullua nga zyra e prokurorit gjatë vitit.

Hera herës, policia abuzoi dhe torturoi të ndaluar minorenë (shih Seksionin 1. A.). Sipas Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (QSHDNJ), disa herë policia përdori kërcënime, dhunë, dhe torturë për t'u marrë rrëfime minorenëve. Në vitin 2003, sipas GSHDNJ, policia përdori mjete të dhunshme kundër tri minorenëve nga Korça, të cilët ishin dëshmitarë në një gjyq, me qëllim që të manipulonin dëshminë e tyre në favor të prokurorisë. Asnjë veprim nuk u ndërmor kundër oficerëve të policisë. Prokurori akuzoi Gjergji Dabullën me trafikimin e tri minorenëve dhe vazhdoi të përdorte fakte për çështjen, të cilat pretendohet se ishin nxjerrë nga minorenët me anë mjetesh të dhunshme.

GSHDNJ pretendoi që policia kishte vënë në shënjestër komunitetin homoseksual të vendit. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Gay Albania, policia shpesh në mënyrë arbitrare arrestoi homoseksualë dhe pastaj abuzoi me ta fizikisht dhe verbalisht gjatë kohës kur këta ishin të ndaluar. Në tetor, Sekretari i Përgjithshëm i Gay Albania deklaroi që i ishte refuzuar nënshtetësia sepse ishte homoseksual.

Pati raportime që policia rrahu protestues gjatë vitit (shih Seksionin 2.b.).

Kushtet në burgje dhe mjediset e paraburgimit mbetën të varfra, pavarësisht nga përpjekjet e qeverisë për të trajtuar probleme të tilla si mjedise të këqija dhe mbipopullim si dhe përpjekjet për të transferuar të dënuarit nga qendrat e paraburgimit në burgje. Sipas Seksionit të Operacioneve të Bashkimit Europian për Reformën Gjyqësore, Azilin dhe Migracionin, të ndaluarit kishin akses të kufizuar në banja dhe dushe, si dhe ushqim të pamjaftueshëm; në disa raste, kufizimet në hapësirë dhe intimitet i ndalonin ata të angazhoheshin në praktika fetare. Nuk ekzistonin mundësi punësimi për të burgosurit. Stafi i burgjeve kishte trainim të dobët. Gjatë vitit, të burgosur dhe të paraburgosur bënë greva në Vlorë, Lezhë dhe Laç dhe zhvilluan greva urie në qendra paraburgimi në Elbasan, Çorovodë, Korçë, Malësi e Madhe, si dhe në burgje në Tiranë dhe Burrel për të protestuar kundër kushteve të këqija të jetesës, ngadalësisë në transferimin e të burgosurve nga qelitë e paraburgimit në burgje dhe kundër mungesës së punësimit në burgje. Nuk pati raportime për plagosje apo vdekje si pasojë e kryengritjeve.

Mbipopullimi mbeti një problem serioz. Kjo shkaktoi kushte nënstandarte jetese për të burgosurit dhe probleme thelbësore sigurie për forcat e policisë. Sipas Ministrisë së Rendit Publik,kapaciteti i përgjithshëm në të gjitha mjediset e paraburgimit arrinte në 803, ndërsa numri faktik i të ndaluarve ishte 1,239. Në korrik, Ministria e Drejtësisë vendosi t'i transferonte të gjithë kundravajtësit e dënuar nëpër burgje; megjithatë, 188 kundravajtës të dënuar vazhdonin të mbeteshin në paraburgim në fund të vitit.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, asnjë i dënuar nuk kreu vetëvrasje.

Transferimi i juridiksionit nga Ministria e Rendit Publik tek Ministria e Drejtësisë për të gjitha qendrat e paraburgimit mandatuar nga një ligj i vitit 2001 u përmbush vetëm pjesërisht dhe qendrat e paraburgimit të Tiranës dhe Vlorës u tranferuan nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë deri në fund të vitit.

Policia i ndau burrat nga gratë në qendrat e paraburgimit dhe burgje. Sipas OJQ-ve që monitoronin kushtet e burgjeve, Burgu 325 për gra në Tiranë nuk kishte mjedise për të porsalindur nga ato të burgosura femra që ishin shtatzënë në kohën e burgosjes. Të paragurgosurit nuk ndaheshin nga të burgosurit e dënuar, dhe të paraburgosurit minorenë nuk ndaheshin nga të rriturit për shkak të mbipopullimit.

Ministria e Drejtësisë raportoi që 49 minorenë kryenin dënime me burgim: 31 në qendra paraburgimi në qendrat e drejtuara nga Ministria e Drejtësisë në Tiranë dhe në Vlorë dhe 18 në Vaqarr – i vetmi burg në vend që ka një mjedis të posaçëm për minorenët. Në total, kishte 39 minorenë që mbaheshin në qendra paraburgimi përveç atyre në Tiranë dhe në Vlorë.

QSHDNJ vërejti që minorenët në Vaqarr përziheshin me të burgosur të rritur për përdorimin e dusheve dhe veprimtari argëtuese. Si rezultat, pati një numër raportimesh për abuzim seksual të minorenëve gjatë vitit. Sipas QSHDNJ, të gjithë minorenëve u mohohej shkollimi në sistemin e paraburgimit. Qeveria nuk i ishte përgjigjur këtij shqetësimi deri në fund të vitit.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati vajza minorene që të kryenin dënime në Burgun 325 për femrat.

Qeveria lejoi vëzhgues ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut që të vizitonin si qendrat e paraburgimit ashtu edhe burgjet; nuk pati raportime për refuzim të lejeve për të hyrë për inspektime për monitorues vendas të pavarur të të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunoi me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) dhe OJQ të tjera.

d. Arrestimi apo Ndalimi Arbitrar

Kushtetuta e ndalon arrestimin apo ndalimin arbitrar; megjithatë, policia me raste arrestoi dhe ndaloi persona në mënyrë arbitrare.

Sipas Ministrisë së Rendit Publik, Policia e Shtetit përfshinte 12,132 oficerë policie; shumica e oficerëve të policisë mbeti gjerësisht e patrainuar, pavarësisht nga asistenca e marrë prej qeverive të huaja. Një ristrukturim i ri i Policisë së Shtetit krijoi dy zëvendës-drejtori: Një për operacionet dhe tjetrën për administratën. Drejtoritë Operative përfshinin: Krimin e Organizuar dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve; Luftën Kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve të Hapura; Rendin Publik dhe Sigurinë; Kontrollin e Territorit dhe Bashkërendimin; si dhe Policinë Kufitare dhe Migracionin. Paraqitja e gjithanshme e zbatimit të ligjit mbeti e dobët. Sjellja joprofesionale dhe korrupsioni mbetën pengesa madhore për zhvillimin e një force të efektshme policore civile. Sipas Ministrisë së Rendit Publik, vetëm 40 përqind e oficerëve të policisë përfituan trainim përtej trainimit bazë. Zyra e Kontrollit të Brendshëm e Policisë së Shtetit mund të angazhohej në

parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale të kryer nga policia dhe, gjatë vitit, kreu hetime që çuan në arrestimin e 52 zyrtarëve të policisë dhe shkarkimin e 323 për nivele të ndryshme shkeljesh të detyrës.

Në statistikat e veta të hershme, Avokati i Popullit – një avokat i ngarkuar me hetimin e ankesave të qytetarëve për kundravajtje të zyrtarëve publikë – raportoi që kishte trajtuar 2,520 ankesa, kërkesa, dhe njoftime të lidhura me të gjitha format e korrupsionit dhe kundravajtjes publike. Nga këto, 19 përqind u vendosën se ishin legjitime dhe iu përcollën autoriteteve përkatëse për hetim të mëtejshëm. Ndër këto 2,520 raste, Avokati i Popullit mori 25 përqind ankesa kundër oficerëve të policisë për përdorim të tepërt të forcës apo keqtrajtim dhe vendosi që 7 ishin të vlefshme, 4 ishin përtej juridiksionit të tij, 13 ishin të pabazuara, dhe 1 u tërhoq; megjithatë, nuk kishte në dispozicion informacion të mëtejshëm mbi statusin e tyre.

Korrupsioni mbeti një problem mes forcave të policisë dhe pagat e ulëta dhe korrupsioni i përhapur gjerësisisht nëpër shoqëri e bënte problemin të vështirë për t'u luftuar. Zyra e Kontrollit të Brendshëm e Policisë së Shtetit i raportoi 223 raste korrupsioni Prokurorisë, në të cilat përfshiheshin 230 punonjës policie; 32 punonjës policie u arrestuan.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1995 përcakton të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar. Me ligj, një punonjës policie apo një prokuror mund të urdhërojë ndalimin e një të dyshuari. Personat e ndaluar duhet të informohen menjëherë për akuzat kundër tyre si dhe për të drejtat e tyre dhe një prokuror duhet njoftuar menjëherë pasi policia të ketë ndaluar një të dyshuar. Brenda 48 orësh pas arrestimit apo ndalimit, i dyshuari duhet të dalë përpara një gjykatësi. Gjykatësi ka 48 orë të tjera për të vendosur nëse i dyshuari mund të vazhdojë të mbetet i ndaluar. Në disa raste, persona të ndaluar janë mbajtur në ndalim paraburgimi më gjatë se 48 orë pa një vendim gjykate mbi faktin nëse prokurori ka apo jo fakte të mjaftueshme.

Gjykata mund të urdhërojë ndalimin në paraburgim në raste veçanërisht serioze që mund të paraqesin rrezik për shoqërinë. Përndryshe, i dyshuari mund të vendoset në arrest shtëpiak. Mund të kërkohet lirim me kusht nëse gjykatësi beson që i akuzuari mund të mos paraqitet për gjyq.

Këshillim ligjor duhet të ofrohet pa pagesë nëse i pandehuri nuk mund të përballojë një avokat privat; megjithatë, kjo e drejtë nuk njihej gjerësisht dhe policia shpesh dështoi në informimin e të dyshuarve për këtë. aksesi ndaj informacionit ligjor mbeti i vështirë për qytetarët. Pati raste të shumta në të cilat personat u ndaluan në mënyrë të jashtëligjshme dhe nuk ishin në gjendje të kontaktonin avokatët e tyre privatë. Në disa raste, të ndaluarit, përfshi edhe minorenët, pyeteshin pa praninë e avokatëve të tyre mbrojtës. Shërbimet e ofruara nga shoqata shtetërore e avokatëve konsideroheshin të pamjaftueshme dhe hera herës me mungesa profesionalizmi.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit citoi nëntë ankesa për arrestime arbitrare dhe ndalime të jashtëligjshme nga policia, dhe specifikoi që disa prej ankimeve kishin bazë dhe iu përcollën zyrës së prokurorit.

Kodi i Procedurës Penale kërkon kryerjen e hetimeve të paraburgimit brenda 3 muajsh; megjithatë, prokurori mund ta shtyjë këtë periudhë me intervale 3-mujore në raste veçanërisht të vështira. Ndalimi i zgjatur në paraburgim si rezultat i hetimeve të vonuara mbeti një problem

serioz. Të akuzuarit dhe pala e dëmtuar kanë të drejtën t'i apelojnë këto shtyrje në gjykatën e rrethit. Disa të burgosur u mbajtën në mjedise paraburgimi edhe pas gjyqit të tyre.

Nuk pati raste të konfirmuara për të ndaluar të mbajtur për arsye thjesht politike. Akuzat kundër Ekrem Spahisë, Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit, në lidhje me vrasjen në vitin 1998 të një deputeti të Partisë Demokratike u pezulluan sepse ai kishte imunitet paralamentar, ndërsa gjyqi i 12 mbështetësve të tij vazhdonte të mbetej pezull në fund të vitit.

e. Mohimi i Gjyqit të Ndershëm Publik

Kushtetuta siguron një gjyqësor të pavarur; megjithatë, për shkak të presionit politik, kërcënimeve, korrupsionit të shumëpërhapur, rryshfeteve, dhe burimeve të kufizuara, një pjesë e madhe e gjyqësorit nuk ishte në gjendje të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe të efektshme.

Tensioni vazhdoi midis policisë, prokurorisë, dhe gjyqësorit sidomos jashtë Tiranës. Secila palë përmendte dështimet e tjetrës si arsye pse kriminelët shmangnin burgosjen; gjykatat akuzonin prokurorët dhe policinë se dështonin të ofronin hetimin dhe faktet e qëndrueshme të nevojshme për ndjekje të suksesshme, dhe policia pretendonte se korrupsioni dhe rryshfetet kishin infektuar gjykatat. Policia Gjyqësore ishte përgjegjëse, nën drejtimin e prokurorëve, për zhvillimin e hetimeve të kryera fillimisht nga policia.

Sistemi gjyqësor përbëhet nga gjykatat e rretheve të shkallës së parë, gjashtë gjykata apeli, gjykatat ushtarake të shkallës së parë dhe apelit dhe Gjykata e Lartë. Ekziston gjithashtu një Gjykatë Kushtetuese e veçantë dhe e pavarur. Gjykata e Lartë merr në shqyrtim apelimet si nga gjykatat e rrethit ashtu edhe nga gjykatat e apelit, ndërsa Gjykata Kushtetuese në radhë të parë shqyrton ato çështje që kërkojnë interpretim kushtetues dhe konfliktet midis degëve të qeverisjes, si edhe çështje të individëve që pretendojnë mohimin e proceseve të merituara gjyqësore. Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda filluan punën gjatë vitit dhe u përqëndruan mbi rritje e efektshmërisë së luftës kundër krimit të organizuar dhe përmirësimit të cilësisë së gjykimit.

Presidenti kryeson Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili ka autoritetin të emërojë, disiplinojë dhe shkarkojë gjykatës të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit. Gjykatësit që shkarkohen kanë të drejtën të apelojnë në Gjykatën e Lartë. Përveç Presidentit, Këshilli përbëhet nga Ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, nëntë gjykatës të të gjitha niveleve zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe tre anëtarë të përzgjedhur nga Parlamenti.

Presidenti i Republikës emëron 17 anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe nëntë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese me pëlqimin e Parlamentit. Parlamenti ka autoritetin të miratojë dhe shkarkojë gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatësit e Gjykatës së Lartë. Sipas Kushtetutës, shkarkimi mund të urdhërohet mbi bazën e shkeljes së kushtetutës, kryerjes së një krimi, inkompetencë fizike ose mendore, ose kryerjen e një akti që diskretiton seriozisht integritetin dhe reputacionin gjyqësor. Gjykatësit e shkarkuar kanë të drejtën e apelit në Gjykatën Kushtetuese.

Paraqitja e Zyrës së Përmbarimit, organi që siguron zbatimin e gjykimeve civile, pavarësisht nga disa përmirësime ishte e dobët dhe, si rezultat, shumë gjykime civile nuk u zbatuan.

Vendi nuk ka një sistem gjyqësor për minorenët, dhe çështjet e fëmijëve shpesh i paraqiteshin gjykatësve që nuk kishin ndonjë shkollim në drejtësinë për minorenët. Sipas QSHDNJ, rritjet e kohëve të fundit në kohëzgjatjen e dënimeve të dhëna për minorenët vinin për shkak të mungesës së trainimit të gjykatësve në të drejtën për minorenët.

Kushtetuta siguron të drejtën për një gjyq të shpejtë; megjithatë, burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, si dhe ngarkesa e çështjeve në shumë raste e penguan sistemin e gjykatave të trajtonte çështjet në kohën e duhur. Vonesat e gjata të çështjeve ishin tipike dhe çuan në ndalimin e të dyshuarve për periudha më të gjata kohe sesa kufijtë ligjorë (shih Seksionin 1.d.). Të pandehurit, dëshmitarët dhe të tjerët që nuk flasin shqip kanë të drejtën e shërbimeve të një përkthyesi. Të pandehurit kanë të drejtën të kenë një avokat dhe, sipas ligjit, Qeveria siguron avokatë për të pandehur të varfër, megjithëse cilësia e përfaqësimit ishte e ndryshueshme. Nëse dënohet, i akuzuari ka të drejtën ta apelojë vendimin brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit. Gjatë vitit, një numër prcesesh, përfshi disa prej proceseve më të rëndësishme të vendit, u zhvilluan në mungesë, për shembull: gjyqi kundër Altin Arapit, vrasësit të dyshuar të shoferit të Prokurorit të Përgjithshëm; gjyqi kundër 13 anëtarëve, 7 prej tyre në mungesë, që organizuan trafikim personash në janar dhe që çoi në vdekjen e 29 personave; si dhe gjyqi i “Gaxhait” kundër 5 anëtarësh të një bande, 4 prej të cilëve po gjykoheshin në mungesë.

Sistemi gjyqësor nuk siguron gjyqet me juri; prokurori dhe avokati mbrojtës kanë të drejtën të jenë të pranishëm përpara një paneli prej tre gjykatësisht, dhe të pandehurit kanë të drejtën të njihen me të gjitha faktet që do të shqyrtohen nga gjykatësit.

Nuk pati raportime për të burgosur politikë.

Në korrik, Parlamenti miratoi një ligj të ri për kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Disa ish-pronarë, përfshi edhe bashkësitë fetare, vunë në pikëpyetje kufizimin e ligjit për kthimin e pronës me një total prej 60 hektarësh. Qeveria nuk ka ngritur një fond monetar për t’u përdorur për qëllime kompensimi. Gjatë vitit, Avokati i Popullit mori 33 ankesa të lidhura me mosmarrëveshje për kompensimin e pronës.

f. Ndërhyrja Arbitrare në Intimitet, Familje, Banesë, apo Korrespondencë

Kushtetuta i ndalon veprime të tilla; megjithatë, me raste, Qeveria i shkeli këto të drejta.

Në qershor, 51 familje rome u detyruan me forcë të braktisnin shtëpitë e tyre, sepse bllokonin zbatimin e planit për rregullimin e territorit të bashkisë.

Seksioni 2 Respektimi i Lirive Civile, Përfshi:

a. Liria e Fjalës dhe e Shtypit

Kushtetuta siguron lirinë e shprehjes dhe të shtypit dhe media ishte aktive dhe përgjithësisht e pakufizuar; megjithatë, pati probleme serioze, themelore, me përdorimin e medias për qëllime politike. Ndërhyrja politike në media ndodhi me pak se sa në vitet e mëparshme. Botuesit dhe

pronarët e gazetave vazhduan të redaktonin artikujt për t'u shërbyer interesave të veta politike dhe ekonomike dhe hera herës të bllokonin ato që u kundërviheshin atyre interesave. Gazetarët vazhduan të praktikonin vetë-censurën. Pati pak transparencë në financimin e organeve të medias.

Partitë politike, sindikatat dhe shoqatat e grupet e ndryshme botonin gazetat ose revistat e tyre. Media e pavarur ishte aktive, por shtrëngohej nga profesionalizmi i kufizuar dhe mungesa e financimeve. Afro 200 botime ishin në qarkullim, përfshi gazetat e përditshme dhe të përjavshme, revista, buletine e pamflete. 3 gazeta botoheshin në greqisht në pjesën jugore të vendit; këto të përditshme dhe të përjavshme kishin shifra shumë të vogla tirazhi.

Radio dhe Televizioni Shqiptar (RTSh) ishte transmetuesi i vetëm publik (30 përqind e buxhetit të tij vinte nga Qeveria, 70 përqind nga burime private), dhe vazhdoi t'i kushtonte pjesën më të madhe të mbulimit Qeverisë. RTSh përfshin një kanal kombëtar televiziv dhe një kanal kombëtar radiofonik. Radio kombëtare jepte shërbime në gjuhë të huaj transmetuar në shtatë gjuhë, përfshi edhe atë greke.

Televizioni kishte influencë shumë të madhe; afro 80 përqind e publikut i marrte lajmet dhe informacionin nga televizioni. Programacioni në televizion përfshinte një masë gazetarie të përgjegjshme; megjithatë, atashimi politik ishte i kudogjendur në programim. Pavarësisht nga disa përmirësime, shumica e stacioneve ishin të njëanshme në pasqyrimin e tyre politik.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) – një organ dypartiak shtatë-anëtarësh zgjedhur nga Parlamenti, me një të emëruar nga Presidenti – merrej me qeverisjen e çështjeve të transmetimit. Kryetari i Këshillit dha dorëheqjen në verë, duke përmendur presione nga transmetues të fuqishëm.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, kundër gazetarëve nuk u përdor dhunë fizike.

Në janar, dy gazetarë të stacionit Top Channel u ndaluan për një kohë të shkurtër sepse patën filmuar fshehtas Kryeministrin në një vend publik.

Në shkurt, forca të sigurisë ndaluan dy gazetarë të stacionit ALSAT TV për disa orë dhe konfiskuan kasetën filmike me xhirime të Kryeministrit tek vizitonte një spital.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati heqje licensash televizive për arsye politike.

Në maj, një grup gazetarësh dhe kryeredaktorësh nxorën një njoftim për shtyp ku ngrinin shqetësime për përpjekjet e Qeverisë për të kufizuar lirinë e shtypit. Ata argumentonin që përdorimi arbitrar nga Qeveria i kontrolleve financiare dhe padive kundër gazetarëve kufizoi lirinë e shtypit; megjithatë, qëndrimi i Qeverisë ishte që ankesat ishin shkaktuar nga irritimi prej një grumbullimi më të efektshëm taksash.

Gazetarët gjithashtu paraqitën ankesa mbi censurë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga botuesit apo kryeredaktorët e tyre për shkak të presionit apo interesit politik apo ekonomik. Mungesa e kontratave të punësimit për shumë gazetarë citohej si një pengesë e shpeshtë për raportim të

pakufizuar. Disa organe të medias u ankuan që shpeshtësia e rritur e kontrolleve të taksave të kryera në zyrat e tyre vinte si ndëshkim për raportime që kritikonin politikat e qeverisë. Nga marsi në maj, dhe përsëri në shtator, zyra e kontrollit të tatimeve kreu inspektime për tatimet pranë gazetës Koha Jonë.

Për shpifjen parashikohen dënime penale, që variojnë nga një gjobë deri në 2 vjet burg. Pati një numër padish të bujshme për shpifje gjatë vitit ku përfshiheshin politikanë dhe gazetarë të njohur. Për shembull, në janar, Kryeministri Nano paditi botuesin dhe Deputetin Nikollë Lesi për shpifje për pretendime të botuara në një numër të gazetës së tij, Koha Jonë, ku pretendohej që Kryeministri në mënyrë të papërshtatshme kishte shpërblyer veten dhe këshilltarët e tij me 5 paga mujore shtesë. Gjykata e shkallës së parë vendosi në favor të Kryeministrit; megjithatë, çështja ishte ende pezull në gjykatën e apelit në fund të vitit.

Në maj, Xhoana Nano, bashkëshortja e Kryeministrit, paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë për të hequr imunitetin parlamentar të Nikollë Lesit me qëllim që të procedonte me akuza penale kundër tij për botimin e artikujve të pafavorshëm për të në gazetën e tij, Koha Jonë. Në shtator, Gjykata e Lartë vendosi në favor të bashkëshortes së Kryeministrit; megjithatë, në nëntor, Parlamenti e zmbrapsi vendimin.

Ish-Ministrja e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve Arta Dade dhe Ministri i Qeverisjes Vendore Ben Blushi paditën Kryetarin e Partisë Demokratike Sali Berisha për shpifje, dhe kompania botuese që zotëron revistën Spektër paditi opinionistin Fatos Lubonja për shpifje; Lubonja më parë kishte shkruar për revistën. Këto çështje ishin pezull në Gjykatën e Rrethit të Tiranës ose në Gjykatën e Apelit në fund të vitit. Në dhjetor, Kryetari i Partisë së Re Demokrate Genc Pollo fitoi një çështje për shpifje kundër Farudin Arapit, Kryetar i Komisionit të Aseteve të Skemave Piramidale.

Në korrik, Partia Demokratike e Shqipërisë anuloi akreditimin e stacionit televiziv privat News 24 pranë partisë dhe i mohoi aksesin në zyrat qëndrore të partisë sepse sipas pretendimeve kishte bërë raportime të anshme. KSHH e denoncoi vendimin si një shkelje të Kushtetutës. Çështja ishte pezull në fund të vitit.

Qeveria nuk kufizoi aksesin ndaj internetit; megjithatë, aksesi në internet mbeti i kufizuar sidomos jashtë kryeqytetit.
Qeveria hera herës kufizoi lirinë akademike. Për shembull, Profesor Doka u shkarkua si shef i Departamentit të Gjeografisë në Universitetin e Tiranës sepse kishte një “përqasje anti-kombëtare në punën e tij” për shkak të botimit të një atlasi që zgjeronte zonat gjeografike të pakicave. Gjithashtu qeveria, pas daljes fillestare në qarkullim, ndaloi botimin e atlasit.

b. Liria e Grumbullimit Paqësor dhe Grupimeve

Kushtetuta siguron lirinë e grumbullimit dhe Qeveria përgjithësisht e respektoi këtë të drejtë në praktikë.

Ligji kërkon nga organizatorët që të njoftojnë policinë e shtetit mbi grumbullime në vende publike 3 ditë përpara protestave. Policia mund të refuzojë t’i lejojë ato vetëm për arsye të sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, parandalimin e akteve terroriste, parandalimin e

krimeve, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, ose për arsye të trafikut; nuk pati raportime se mohime të tilla u bënë në mënyrë arbitrare.

Pati pak raste ku policia keqtrajtoi protestues gjatë vitit. Në prill, protestuesit u ndeshën me policinë në lidhje me kompensimin e ish të burgosurve politikë dhe viktimave të persekutimit politik për punën e tyre të papaguar gjatë burgimit apo persekutimit të tyre; shumë protestues u shoqëruan dhe ndaluan në komisariate të policisë për disa orë. Policia nuk ngriti padi.

Gjatë vitit, Mjaft, një lëvizje qytetare rinore, organizoi një sërë protestash dhe shpesh hasi probleme me policinë në lidhje me lejet për të protestuar. Policia ngriti padi kundër disa organizatorëve të Mjaft, por asnjë gjyq nuk pati filluar deri në fund të vitit.

Kushtetuta mbështet të drejtën e grupimeve, dhe Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë. Megjithatë, Kushtetuta ndalon formimin e ndonjë partie politike a organizate që është totalitare; nxit dhe mbështet urrejtjen racore, fetare apo etnike; përdor dhunën për të marrë pushtetin apo për të influencuar mbi politikat shtetërore; apo është jotransparente apo e fshehtë në karakter. (shih Seksioni 3). Nuk pati raportime që një dispozitë e tillë të përdorej kundër ndonjë grupi gjatë vitit.

c. Liria e Fesë

Kushtetuta siguron lirinë e fesë dhe Qeveria përgjithësisht e respektoi këtë të drejtë në praktikë. Nuk ka ndonjë fe zyrtare dhe të gjitha fetë janë të barabarta; megjithatë, bashkësitë mbizotëruese fetare (myslimanët sunitë, myslimanët bektashinj, ortodoksët, dhe katolikët romanë) gëzojnë një shkallë më të madhe njohjeje zyrtare (p.sh., festat kombëtare) dhe status shoqëror bazuar mbi praninë e tyre historike në vend. Lëvizjet fetare mund të fitojnë statusin zyrtar të një personi juridik duke u regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës sipas Ligjit mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse, i cili njeh statusin e një shoqate jo-fitimprurëse pavarësisht nëse organizata ka një karakter kulturor, argëtues, fetar, apo humanitar.

Ndërkohë që Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare, Komiteti Shtetëror për Kultet mban regjistra dhe statistika mbi organizatat e huaja fetare që e kontaktojnë atë për asistencë.

Aleanca Ungjillore Shqiptare, një shoqatë e afërsisht 87 Kishave Protestante, u ankua se kishte hasur pengesa administrative në aksesin në media. Megjithatë, përfaqësues të Aleancës Ungjillore deklaruan se nuk ishte e qartë nëse aksesi i kufizuar ishte për shkak të përmasave të vogla të organizatës apo përkatësisë së saj fetare.

Në shkollat publike nuk jepeshin mësime fetare. Nuk ka ligj që ndalon demonstrimin e përkatësive fetare në shkollat publike; megjithatë, disa nxënës nuk u lejuan ta bënin këtë në praktikë. Sipas Ministrisë së Arsimit, në vend kishte 14 shkolla fetare, me afërsisht 2,600 nxënës.

Në vitin 2003, një studenti mysliman iu ndalua fotografia e diplomës sepse kishte mjekër. Studenti në fund u lejua të diplomohej me anë të ndërhyrjes së Avokatit të Popullit.

Qeveria dështoi t'u kthente komuniteteve të ndryshme fetare të gjitha pronat dhe objektet fetare, të cilat u konfiskuan gjatë regjimit komunist në vitin 1967. Në rastet kur ndërtesat fetare u kthyen, Qeveria shpesh nuk ktheu tokën që rrethonte ndërtesat, as nuk ofroi kompensim të përshtatshëm. Qeveria gjithashtu nuk ishte në gjendje të kompensonte kishat në masën e duhur për dëmet e gjera që shumë prona fetare vuajtën.

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë u ankua se, përveç problemeve në rimarrjen e pronave, gjithashtu pati vështirësi në marrjen e disa ikonave fetare nga Qeveria për restaurim dhe mbrojtje dhe raportoi disa raste të izoluara vandalizmi ndaj kishave dhe kryqeve.

Në qershor, Kastriot Myftari, autor i librit "Islamizmi Kombëtar Shqiptar," u çlirua nga të gjitha akuzat për nxitje të urrejtjes fetare.

Marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme fetare ishin përgjithësisht miqësore. Megjithatë, përfaqësues të Kishës Ortodokse të vendit vërejtën se disa kisha dhe ndërtesa të tjera ishin shënjestra të vandalizmit, edhe pse këto incidente ishin të izoluara dhe besohej të ishin më shumë rezultat i rendit të dobët publik të vendit se sa për shkak të intolerancës fetare. Në fund të vitit, hetimi mbi vrasjen në janar të vitit 2003 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkësisë Myslimane Sali Tivari, vazhdonte.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, bashkësia bektashiane nuk përjetoi shantazhe, kërcënime, vandalizëm, apo dhunë.

Për një diskutim më të hollësishëm, shih Raportin Ndërkombëtar për Lirinë Fetare për vitin 2004.

d. Liria e Lëvizjes Brenda Vendit, Udhëtimi Jashtë, Emigrimi dhe Riatdhesimi

Kushtetuta i siguron këto të drejta, dhe Qeveria përgjithësisht i respektoi ato në praktikë.

Si rezultat i migracionit të konsiderueshëm brenda vendit, shumë qytetarë nuk kishin më regjistrim dhe status vendor, çka çoi në humbjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë të tilla si arsimi dhe kujdesi shëndetësor. Në shumë institucione arsimore, nxënësit, midis dokumentave të tjera, duhet të kenë edhe një dokument zyrtar nga autoritetet e rrethit që njeh që ata janë banorë të rrethit. Mungesa e këtyre dokumentave pengonte shumë nxënës të ndiqnin shkollën, dhe bashkësia rome ishte veçanërisht e prekur nga kjo.

Pati pak përparim në projektin e Ministrisë së Qeverisjes Vendore për krijimin e një dokumenti kombëtar identifikimi të standartizuar.

Kushtetuta e ndalon azilin e detyruar dhe Qeveria nuk e përdori këtë.

Ligji siguron akordimin e azilit apo statusit të refugjatit në përputhje me Konventën e vitit 1951 të OKB-së Lidhur me Statusin e Refugjatëve apo Protokollin e Vitit 1967. Në praktikë, Qeveria ofroi mbrojtje kundër mosakordimit të statusit, d.m.th. kthimit të një personi në një vend ku kishin frikë nga persekutimi. Qeveria akordoi status refugjati apo azil. Qeveria gjithashtu ofroi

mbrojtje të përkohshme për individë që mund të mos kualifikohen si refugjatë apo azilantë sipas Konventës 1951/ apo Protokollit të vitit 1967; kjo u bë për afërsisht 17 individë. Ekziston një procedurë apelimi, por kjo nuk funksiononte gjatë vitit.

Qeveria bashkëpunoi me zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ndihmuar refugjatët dhe azilkërkuesit. UNHCR, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Pritëse të Azil-Kërkuesve, në varësi të shtetit, ofroi shërbime shoqërore dhe ligjore, mbulim të kujdesit shëndetësor, siguracion, dhe mbështetje të kufizuar me trainime për bashkësinë e vogël të refugjatëve të vendit dhe bashkërendoi asistencën e mëtejshme nëpërmjet një rrjeti OJQ-sh.

Në prill, së bashku me organizata ndërkombëtare (UNHCR, Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE), Qeveria, nëpërmjet Programit CARDS të Bashkimit Europian, zgjeroi programin e parakontrollit tek imigrantët e paligjshëm të ndaluar në të gjitha pikat e kalimit të kufirit.

Seksioni 3 Respektimi i të Drejtave Politike: E Drejta e Qytetarëve për të Ndryshuar Qeverinë e Tyre

Kushtetuta u siguron qytetarëve të drejtën për të ndërruar qeverinë e tyre paqësisht dhe qytetarët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike të mbajtura mbi bazën e votimit universal.

Megjithëse zgjedhjet vendore të vitit 2003 rezultuan me një numër përsëritjesh, në përgjithësi zgjedhjet plotësuan standartet demokratike bazë dhe policia, udhëheqja e fushatave zgjedhore, disa zyrtarë vendorë zgjedhjesh, dhe institucionet zgjedhore i kryen mirë detyrat e tyre. Megjithatë, zgjedhjet u dëmtuan nga refuzimet e përsëritura të udhëheqjes politike në dy partitë kryesore për të pranuar rezultatet që nuk u pëlqenin. Rekomandimet e OSBE-së dhe të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) për zgjedhjet vendore bënin thirrje për ngritjen e një komisioni parlamentar dypartiak që do të trajtonte mangësitë në sistemin zgjedhor. Nga korriku deri në dhjetor, komisioni dypartiak trajtoi mangësitë e lidhura me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, listat e votuesve, procedurat e numërimit të votave, dhe financimin e partive, midis të tjerash, për t'u përgatitur për zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme në verën e vitit 2005. Amendamentet e propozuara nga komisioni dypartiak për kodin zgjedhor ishin në pritje të miratimit nga Parlamenti deri në fund të vitit.

Një numër partish politike morën pjesë në sistemin politik; Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD) ishin dy më të mëdhatë dhe mbanin shumicën e vendeve në Parlament. PS, formuar nga ish-Partia Komuniste (e njohur si Partia e Punës) në vitin 1991, udhëhiqte palën qeverisëse gjatë vitit. Koalicioni i saj përfshinte PBDNJ, Partinë Social-Demokrate, Partinë Agrare, Partinë Aleanca Demokratike dhe Partinë Demokracia Sociale. Kryetari i Partisë Socialiste Fatos Nano gjithashtu shërbente si Kryeministër. PD, e udhëhequr nga ish-Presidenti Sali Berisha, ishte partia kryesore opozitare.

Një parti politike duhet të aplikojë në Gjykatën e Rrethit të Tiranës për regjistrim dhe të deklarojë një qëllim apo synim që nuk është anti-kushtetues apo përndryshe në kundërshtim me

ligjin, të përshkruajë strukturën e vet organizative, dhe të shpjegojë të gjitha fondet publike dhe private që merr. Regjistrimi akordohej në mënyrë rutinë; megjithatë, në prill, Partisë Mëmëdheu, përbërë nga anëtarë të bashkësisë myslimane, iu mohua regjistrimi. Themeluesit e partisë riaplikuan dhe në nëntor regjistrimi iu akordua.

Korrupsioni mbeti një pengesë madhore ndaj reformave domethënëse në vend. Qeveria pati krijuar një post të posaçëm ministerial për t'u marrë me çështjet e korrupsionit, si dhe kishte miratuar legjislacion të ri antikorrupsion. Në vitin 2003, u ngrit Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (ILDKP) për të mbikqyrur deklarimet e zyrtarëve publikë. Nga 4,160 formularë deklarimi që ILDKP shqyrtoi gjatë vitit, vetëm 2 çështje iu përcollën prokurorisë për hetim të mëtejshëm penal. Megjithatë, në mungesën e një ligji kombëtar mbi konfliktin e interesave, zyrtarë të lartë qeveritarë vazhduan të mbanin poste publike edhe kur dukej se kjo ishte në konflikt me interesat e bizneseve të tyre private. Gjatë vitit, prokuroria u mor me 376 raste të zyrtarëve qeveritarë të akuzuar për abuzim të detyrës dhe lloje të tjera korrupsioni; megjithatë, në këto çështje nuk u dhanë ndëshkime madhore. Në gusht, Management System International (MSI) publikoi një sondazh që raportonte se 94 përqind e publikut të përgjithshëm dhe 90 përqind e menaxherëve të bizneseve besonin që korrupsioni mes zyrtarëve publikë ishte i përhapur gjerësisht.

Kushtetuta garanton të drejtën për akses ndaj informacionit; sipas Ligjit mbi Aksesin ndaj Informacionit, të gjithë qytetarët, përfshi edhe median e huaj, kanë të drejtën të marrin informacion mbi veprimtaritë e organeve të qeverisë, si dhe të personave që ushtrojnë funksione zyrtare shtetërore. Sipas këtij ligji, personat në poste me autoritet publik janë të detyruar të japin të gjithë informacionin, dokumente zyrtare, përveç dokumenteve të klasifikuara, sekreteve shtetërore, etj. Megjithatë, ky ligj nuk është zbatuar plotësisht dhe aksesi ndaj informacionit për qytetarët dhe joqytetarët mbeti problem. për shembull, një OJQ vendase ngriti padi kundër Ministrisë së Arsimit sepse kjo i kishte mohuar aksesin ndaj informacionit që kishte kërkuar. Gjyqi vazhdonte në fund të vitit.

Në Parlamentin me 140 vende kishte 9 gra. Në Kabinet kishte vetëm një grua, Ministrja e Integrimit. Partitë politike kryesore kishin organizata të grave, dhe gratë shërbenin në komitetet e tyre qendrore; megjithatë, në përgjithësi, gratë ishin të nënpërfaqësuara në qeveritë qendrore dhe vendore, dhe pak ishin të zgjedhura në poste publike në çfarëdo nivelesh. Gjatë zgjedhjeve për qeverisjen vendore në vitin 2003, më pak se 3 përqind e të gjithë kandidatëve ishin femra.

Një numër anëtarësh të pakicës greke shërbenin si në Parlament ashtu edhe në degën ekzekutive, në poste ministeriale dhe nën-ministeriale dhe në Parlamentin prej 140 vendesh kishte një anëtar të pakicës vllahe. Nuk mendohej se pakica të tjera përfaqësoheshin në Parlament apo Kabinet.

Votimi familja ndodhte kudo, por ishte më i zakonshëm në zonat fshatare.

Seksioni 4 Qëndrimi Qeveritar në Lidhje me Hetimin Ndërkombëtar dhe Joqeveritar të Shkeljeve të Pretenduara të të Drejtave të Njeriut

Një numër grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut operonin përgjithësisht pa kufizim nga qeveria, duke hetuar dhe botuar gjetjet e tyre mbi çështje të të drejtave të njeriut.

Zyrtarë të Qeverisë ishin gjithnjë e më bashkëpunues dhe reagues ndaj pikëpamjeve të tyre; megjithatë, në disa fusha – si dhuna kundër grave, përfshi dhunën në familje, dhe çështjet e fëmijëve – u bë pak përparim. Një sërë OJQ-sh vendore ishin aktive në trajtimin e problemeve të të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga asistenca e donatorëve ndërkombëtarë, puna e këtyre organizatave pengohej nga mungesa e fondeve dhe pajisjeve.

Nuk pati raportime për kufizim nga qeveria të veprimtarive të OJQ-ve vendase të të drejtave të njeriut. KSHH monitoroi çështje të të drejtave të njeriut në lidhje me pakicat, forcat e sigurisë, gjyqësorin dhe zgjedhjet. GSHDNJ, përkrah ofrimit të asistencës ligjore, operonte një qendër ankesash dhe kreu trainim për policinë. Të dyja organizatat funksionuan në mënyrë të pavarur nga Qeveria dhe shpesh nxorën njoftime për shtyp dhe raporte që kërkonin veprime nga Qeveria. QSHDNJ ishte e vetmja organizatë që monitoronte të drejtat e fëmijëve në vend. OJQ-ja Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (ZMQ), shërbente si një roje kundër korrupsionit dhe si njësi investiguese; qytetarët mund të telefononin në një numër të posaçëm të ZMQ për të raportuar korrupsion në qeveri.

Qeveria bashkëpunoi me organizata ndërkombëtare, të tilla si UNHCR, IOM, dhe ICRC dhe nuk kufizoi aksesin e tyre në vend.

Avokati i Popullit hetoi veprime të papërshtatshme, joadekuate apo të jashtëligjshme nga ana e Qeverisë. Megjithëse i mungonte pushteti për të vënë në zbatim vendime, Avokati i Popullit veproi si një roje ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Rastet më të shpeshta përfshinë ankesa të qytetarëve për abuzim pushteti nga policia e ushtria, mungesë të zbatimit të gjykimeve nga gjykatat në çështjet civile, shkarkime të gabuara dhe mosmarrëveshje për tokën (shih Seksionet 1.c. dhe 1.e.). Në shumë raste, Qeveria ndërmori veprime konkrete për të korrigjuar probleme në përgjigje të gjetjeve të Avokatit të Popullit; megjithatë, mosmarrëveshjet midis Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë së Përgjithshme penguan bashkëpunimin.

Seksioni 5 Diskriminim me Bazë Racën, Seksin, Paaftësinë, Gjuhën apo Statusin Shoqëror

Kushtetuta e ndalon diskriminimin me bazë seksin, racën, etninë apo gjuhën; megjithatë, diskriminimi kundër grave dhe grupeve të pakicës rome mbeti.

Gratë

Nuk kishte legjislacion që të trajtonte në mënyrë specifike dhunën kundër grave apo dhunën në familje; megjithatë, dhuna kundër grave dhe abuzimi bashkëshortor mbetën probleme serioze. Në shoqërinë e vendit që është tradicionalisht e dominuar nga meshkujt, pranimi kulturor dhe përgjigja e dobët e policisë bënë që shumica e abuzimeve të mos raportohen. Përdhunimi është i ndëshkueshëm me ligj, ashtu si dhe përdhunimi bashkëshortor; megjithatë, në praktikë përdhunimi bashkëshortor nuk raportohet apo ndiqet penalisht. Konceptet e përdhunimit bashkëshortor dhe ngacmimit seksual nuk ishin të përcaktuara mirë dhe, për pasojë, akte të tilla shpesh nuk u konsideruan krime nga autoritetet apo publiku. Për këtë arsye, ishte e vështirë të përcaktohej numri i grave që kanë përjetuar përdhunim, dhunë në familje apo ngacmim seksual; megjithatë, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza vërejti që në vitin 2002, linja e saj telefonike e posaçme në Tiranë mori 80-100 telefonata në muaj nga gra që raportonin një formë të dhunës.

Një sondazh i vitit 1999, organizuar nga OJQ Qendra Këshillimore për Gratë dhe Vajzat, tregoi që 64 përqind e femrave të pyetura kishin përjetuar një formë të abuzimit fizik, emocional apo seksual; nuk pati statistika të mëvonshme. Komiteti Shtetëror për Gratë dhe Fëmijët është agjencia kryesore qeveritare që trajton statusin e grave; megjithatë, ai nuk kishte financim të mjaftueshëm dhe i mungonte influenca politike.

Një OJQ mbante një strehëz në Tiranë për gra të abuzuara, megjithëse mjedisi kishte kapacitetin për të strehuar vetëm pak viktima njëherësh. E njëjta OJQ gjithashtu mbante një linjë telefonike të posaçme që ofronte këshilla dhe këshillim për gra dhe vajza.

Ligji e ndalon prostitucionin, por ai ishte problem. Trafikimi i grave për qëllim shfrytëzimi seksual mbeti problem (shih Seksioni 5, Trafikimi).

Shumë burra, sidomos ata nga pjesa verilindore e vendit, vazhdonin të ndiqnin kodin tradicional të pashkruar – kanunin – në të cilin, sipas disa interpretimesh, gratë konsiderohen se janë dhe trajtohen si pronë. Sipas kanunit, disa interpretime diktojnë që detyra e gruas është që t'i shërbejë burrit të saj dhe të jetë inferiore ndaj tij në të gjitha çështjet.

Vrasja në shkurt e një vajze 21-vjeçare nga i ati i saj për vonesë dhe dënimi më pas i të atit me më pak se 2 vjet burgim mori shumë vëmendje nga media dhe nga bashkësia e OJQ-ve; megjithatë, çështja nuk u apelua.

Gratë nuk u përjashtuan, as me ligj as në praktikë, nga ndonjë vend pune; megjithatë, ato nuk ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të fushave të tyre. Kodi i Punës detyron pagesë të barabartë për punë të barabartë; megjithatë, ndërkohë që gratë vazhduan të fitonin gradualisht pushtet ekonomik, kjo dispozitë nuk u zbatua plotësisht. Gratë gëzonin akses të barabartë ndaj arsimit të lartë, por nuk iu akorduan shanse të plota dhe të barabarta në karrierat e tyre dhe gratë me arsim të mirë ishin shpesh të nënpunësuara apo punonin jashtë fushës së specializimit të tyre.

Në korrik, Parlamenti miratoi një Ligj të ri mbi Barazinë Gjinore, i cili garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë, promovon mundësi të barabarta me qëllim eliminimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, dhe përcakton përgjegjësitë e politikave qeveritare që promovojnë barazinë gjinore. Megjithatë, disa OJQ e kritikuan ligjin e ri si të shkruar keq dhe të financuar pamjaftueshëm. Sipas ligjit, Komiteti për Mundësi të Barabarta i Qeverisë ishte detyruar për të shkruar, promovuar dhe monitoruar programe të barazisë gjinore për të gjithë vendin. Megjithatë, Komiteti ishte i keqfinancuar dhe i mungonte ndikimi politik. Ligji i ri gjithashtu krijoi një organ këshillues, Komitetin Ndër-Ministror për Barazinë Gjinore.

OJQ të ndryshme punonin për të promovuar të drejtat e gruas. Disa prej këtyre grupeve promovuan me sukses ndërgjegjësimin publik në lidhje me dhunën në familje dhe zbatuan programe për fuqizimin e gruas; megjithatë, aftësia e tyre për të bërë lobing pranë Qeverisë individë të tjerë të shquar për të sjellë ndryshime faktike në politikat dhe praktikat qeveritare në lidhje me çështjet e gruas mbeti e kufizuar.

Fëmijët

Përkushtimi i Qeverisë ndaj të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve është e kodifikuar në ligjet e brendshme; megjithatë, në praktikë, pati përkushtim të kufizuar.

Ligji parashikon të drejtën për 9 vjet shkollim falas si dhe autorizon shkolla private. Ndjekja e shkollës ishte e detyrueshme deri në klasën e nëntë (ose deri në moshën 16-vjeçare, cilado vinte më shpejt); megjithatë, në praktikë, shumë fëmijë largoheshin nga shkolla më herët se sa lejohet nga ligji me qëllim që të punonin me familjet e tyre, sidomos në zonat fshatare (shih Seksioni 6.d.). Prindërit duhej të paguanin për pajisje, libra, materiale shkollore, si dhe ngrohës për disa klasa, çka ishte e shtrenjtë deri në pamundësi për shumë familje. Mungesa e dokumentave të përshtatshme – shumë prej të cilave kishin humbur për shkak të migracionit të brendshëm – pengonte shumë nxënës të ndiqnin shkollën (shih Seksioni 2.d.). QSHDNJ vlerësonte se vetëm 62 përqind e vajzave që mbaronin shkollën fillore vazhdonin shkollën e mesme; përqindja ishte më e lartë për djemtë, por në fund të vitit të dhënat mungonin. Sipas UNICEF, përqindja e ndjekjes së shkollës fillore për të gjithë fëmijët në moshën nga 7 deri në 14 vjeç ishte 90 përqind. Përqindja neto e regjistrimit në shkollën fillore ishte 97 për djemtë dhe vajzat sëbashku.

Në parim, kishte akses të barabartë ndaj kujdesit shëndetësor si për djemtë ashtu edhe për vajzat; megjithatë, niveli i lartë i rryshfet-dhënies në sistemin e kujdesit shëndetësor hera herës e kufizonte aksesin.

Pas një dhjetëvjeçari migracioni domethënës të brendshëm, pagesat e larta për regjistrim civil kanë penguar shumë qytetarë që të regjistrohen pranë autoriteteve në vendet e tyre faktike të banimit. Si rezultat, fëmijët e lindur nga këta individë nuk kanë certifikata lindjeje apo dokumentacion tjetër ligjor. Ligji kërkon që prindërit që nuk regjistrojnë fëmijët e tyre brenda 30 ditësh nga lindja e fëmijës, që të shkojnë në gjykatë, ku ka gjasa të vendosen gjoba për mosregjistrim të duhur qysh në fillim. Kështu, vendi ka një popullsi të madhe – dhe në rritje – fëmijësh vulnerabël, të paregjistruar, të cilët janë në rrezik trafikimi apo shfrytëzimi, veçanërisht nga bashkësia rome.

Sipas statistikave mbi vitin lëshuar nga Komiteti Kombëtar i Pajtimit, deri 160 fëmijë mbeteshin të rrezikuar nga gjakmarrje që preknin familjet e tyre; 73 prej këtyre fëmijëve konsideroheshin se jetonin në rrethana veçanërisht të rrezikshme (shih Seksioni 1.a.).

Abuzimi i fëmijëve, përfshi abuzimin seksual, raportohej rrallë; megjithatë, autoritetet dhe OJQ-të besonin që ishte i kudondodhur. Sipas Ministrisë së Rendit Publik, 25 raste krimesh seksuale kundër fëmijëve ishin raportuar gjatë vitit. Trafikimi i fëmijëve, edhe pse jo i shumëpërhapur, ishte problematik (shih Seksioni 5, Trafikimi). Në pak raste, kriminelët rrëmbenin fëmijë nga familjet apo jetimoret për t'i shitur tek rrjetet e prostitucionit apo pedofilisë jashtë vendit dhe pati raportime që disa familje i patën shitur fëmijët e tyre tek trafikantët (shih Seksioni 5, Trafikimi).

Puna e fëmijëve mbeti një problem madhor. OJQ-të vlerësonin se kishte afërsisht 50,000 fëmijë që punonin me kohë të pjesshme ose të plotë. Nuk ka legjislacion apo politika qeveritare që merren me rregullimin e këtij shqetësimi (shih Seksioni 6.d.).

Fëmijët e pastrehë, të zhvendosur apo të rrugëve mbetën problem, sidomos fëmijët romë. Fëmijët romë jetonin në varfëri ekstreme anembanë vendit. Ata lypnin në rrugë apo bënin punë të tjera të vockla dhe shumë imigronin në vendet fqinje, sidomos gjatë verës.

Nuk ka ndonjë autoritet shtetëror përgjegjës për fëmijët. Qysh nga korriku, Komiteti Shtetëror për Mundësi të Barabarta, i cili zëvendësoi Komitetin Shtetëror për Gruan dhe Familjen, nuk kishte më një mandat mbi çështjet e fëmijëve.

OJQ të ndryshme dhe organizata ndërkombëtare punonin mbi çështje që lidheshin me trafikimin e fëmijëve. Gjithashtu, organizata Save the Children krijoi një program zhvillimi të fëmijërisë së hershme; organizata Catholic Relief Services sponsorizoi program pas-shkollore dhe promovoi një angazhim më të madh të komuniteteve në sistemin arsimor, dhe UNICEF punoi për zhvillimin e një sistemi të drejtësisë për minorenët.

Trafikimi i Personave

Ligji e penalizon trafikimin e personave dhe ofron ndëshkime për trafikuesit; megjithatë, trafikimi i personave, në veçanti i grave dhe fëmijëve, mbetën probleme serioze. Korrupsioni dhe përfshirja e policisë në trafikim ishte problem.

Sipas Kodit Penal, ndëshkimet për trafikimin njerëzor për shfrytëzim seksual apo punë të detyruar janë: Trafikimi i personave (5 deri 15 vjet burgim); trafikim i femrave për prostitucion (7 deri 15 vjet burgim); dhe trafikimi i minorenëve (15 deri 20 vjet burgim). Rrethanat përkeqësuese, të tilla si rrëmbimi apo vdekja, mund të rrisin ashpërsinë e dënimit deri në një maksimum burgimi të përjetshëm.

Në shkurt, Parlamenti miratoi shtimin e gjobave përkrah ndëshkimeve ekzistuese: Ata që dënohen për shfrytëzim për prostitucion të një minoreni gjobiten me 4,000 USD deri 6,000 USD (400,000 deri 600,000 lekë); për gratë, gjoba është 3,000 USD deri 6,000 USD (300,000 deri 600,000 lekë). Gjithashtu, Kodi Penal i amenduar deklaron që çdo zyrtar qeveritar apo punonjës civil i dënuar për shfrytëzim për prostitucion përballet me 125 përqind të ndëshkimit standart. Në tetor, Parlamenti miratoi një ligj të ri që mandaton sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve nëse burimet e tyre vijnë nga krimi i organizuar dhe trafikimi.

Ndjekja penale e trafikantëve mbeti problem; trafikantët që arrestoheshin shpesh liroheshin për shkak të fakteve të pamjaftueshme, dhe, nëse ndiqeshin, shpesh akuzoheshin për krime më të lehta ose u jepej më pak se sa dënimi minimal për trafikimin. Gjatë vitit, sipas Prokurorisë, pati 234 çështje në vazhdim për trafikim personash dhe 362 individë ishin dënuar për trafikim personash gjatë vitit. Për shembull, dy tutorë, të cilët keqtrajtuan një vajzë nga Tirana dhe e trafikuan atë në Itali për të punuar si prostitutë, u dënuam me 17 dhe 19 vjet burgim.

Në vitin 2003, policia arrestoi një numër anëtarësh të ushtrisë nën dyshimin e përdhunimit dhe trafikimit të një vajze 16-vjeçare; vajza u fut fshehurazi në bazën detare Bishti i Pallës për të kryer seks me marinarë të rekrutuar dhe mbahej në një ndërtesë gjysmë të braktisur në bazë për dy muaj dhe u përdhunua në mënyrë të përsëritur përpara se të trafikohej në Kosovë. Një total prej 11 oficerësh dhe nënoficerësh – përfshi edhe 7 pjesëmarrësit – u pezulluan apo emëruan

tjetërkund. Prokurorët i tërhoqën akuzat kundër njërit prej trafikuesve të pretenduar të vajzës në gusht, dhe gjyqi i tetë marinarëve dhe dy civilëve filloi në tetor. Dy individë të tjerë, të cilët pretendohen për përfshirje, nuk janë paditur ende formalisht.

Çështja e vitit 2003 kundër pjesëtarëve të një rrjeti trafikimi fëmijësh në Durrës, ku përfshiheshin një zyrtar i doganës në port dhe kreu i zyrës lokale të SHISH, nuk kishte shkuar në gjyq deri në fund të vitit.

Në gusht, një goditje rajonale anti-trafikim organizuar me anë të Qendrës së Nismës së Bashkëpunimit në Europën Juglindore quajtur Mirazh III, rezultoi në 125 arrestime për forma të ndryshme trafikimi, prostitucioni, dhe kontrabande. Në fund të vitit, 65 të dyshuar ishin ende në burg.

Në mars, Parlamenti miratoi një ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve; megjithëse ligji hyri në fuqi në nëntor, Qeveria nuk e zbatoi atë deri në fund të vitit. Kjo pengoi aftësinë e Qeverisë për të ngritur çështje të forta kundër trafikantëve, megjithëse bashkëpunimi nga bashkësia ndërkombëtare çoi në rivendosjen dhe mbrojtjen e tre dëshmitarëve jashtë vendit gjatë vitit. Viktimat shpesh nuk e identifikonin veten si persona të trafikuar dhe nuk kishin vullnetin të dëshmonin, për shkak të frikës nga hakmarrja prej trafikantëve dhe mosbesimit tek policia. Bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë mbeti i dobët.

Vendi ishte edhe burim edhe vend tranzit në radhë të parë për gra dhe fëmijë të trafikuar për qëllim shfrytëzimi seksual dhe pune të detyruar, përfshi edhe lypjen. Në një masë më të ulët se sa në vitet e mëparshme, vendi shërbeu si rrugë tranziti për gra dhe vajza të trafikuara. Shumica e grave dhe vajzave të trafikuara u transportuan në Itali, Greqi, dhe – në një shkallë më të vogël – në vende të tjera europiane, si Belgjika, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Hollanda dhe Norvegjia. Pati një rritje domethënëse të trafikimit të fëmijëve në Kosovë për shfrytëzim si lypës dhe për qëllime seksuale. Trafikantët përdorën gjerësisht rrugë tokësore si Shqipëri-Maqedoni-Greqi ose Shqipëri-Mal i Zi ose falsifikonin dokumentet për të transportuar viktimat e tyre me rrugë ajrore ose me tragete. Trafikimi i brendshëm u rrit në mënyrë domethënëse gjatë vitit.

Sipas Ministrisë së Rendit Publik, 4,000 fëmijë ishin trafikuar nga vendi midis viteve 1992 dhe 2000. Fëmijët përgjithësisht ishin trafikuar për lypje të detyruar ose shfrytëzim seksual. Bashkësitë rome dhe egjiptiane ishin veçanërisht të prekshme për shkak të varfërisë dhe analfabetizmit. Fëmijët trafikoheshin edhe për lypje. Të tillë fëmijë shpesh bliheshin prej familjeve dhe në pak raste u rrëmbyen, sipas raportimeve, për lypje ose punë jashtë vendit.

Për shembull, në Nëntor 2003, pesë persona (dy në Korçë dhe tre në Pogradec) morën dënime me burgim që varionin nga 15 deri në 20 vjet për trafikim të foshnjeve të porsalindura në Greqi. Në fund të vitit, çështja ishte apeluar, pasi i ishte përcjellë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Gjithashtu në nëntor 2003, pati raportime të medias se një familje shqiptare i pati shitur djalin 3-vjeçar një burri italian; autoritetet italiane më pas arrestuan dy persona të përfshirë në këtë shitje.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, 3,300 fëmijë shqiptarë të pashoqëruar jetonin në Itali, megjithëse jo të gjithë ishin viktima të trafikimit. Një studim i vitit 2002 kryer nga OJQ International Social Service raportoi që 1,800 fëmijë të pashoqëruar shqiptarë – shumë prej të cilëve ishin viktima të

trafikimit – jetonin në Greqi; megjithatë, sipas Terre des Hommes, një OJQ zvicerane e kujdesit për fëmijët që punonte në vend, numri i fëmijëve të trafikuar në Greqi ka rënë gjatë viteve të fundit.

Gra dhe vajza të huaja në tranzit e kishin origjinën kryesisht nga Serbia dhe Mali i Zi (Kosovë), dhe – në një masë më të ulët – nga Moldavia, Rumania, Ukraina, Rusia dhe Bullgaria. Trafikantët në mënyrë tipike konfiskonin dokumentet e viktimave, i abuzonin ato fizikisht dhe seksualisht, dhe disa herë i detyronin të punonin si prostituta përpara se të largoheshin nga vendi. Si qytetaret ashtu edhe gratë e huaja të trafikuara nga rrjete vendase të krimit të organizuar abuzoheshin, torturoheshin dhe përdhunoheshin. Trafikantët gjithashtu kërcënonin shumë prej anëtarëve të familjeve të viktimave.

Forma kryesore e rekrutimit kishte të bënte me martesa fiktive ose premtime për martesë, ku trafikanti i joshte viktimat jashtë vendit si prostituta. Për shkak të situatës së varfër ekonomike, burra e gra nga grupe të organizuara kriminale joshën shumë gra e vajza nga i gjithë vendi duke u premtuar punë në Itali dhe Greqi. Në një masë më të vogël pati shitje të viktimave trafikantëve nga anëtarët e familjeve apo fqinjët ose me anë të rrëmbimit, përfshi edhe nga jetimoret, ndodhi, sidomos mes fëmijëve romë.

Policia shpesh ishte e përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në trafikim. Gjashtë oficerë policie u arrestuan për trafikim, por nuk rezultoi asnjë dënim dhe asnjë zyrtar tjetër qeveritar nuk u ndoq penalisht për trafikim gjatë vitit. Avokatët dhe gjykatësit gjithashtu u manipuluan dhe iu dha rryshfet, duke i lejuar trafikantët të blinin lirimin nëse arrestoheshin. Gjatë vitit, Zyra e Kontrollit të Brendshëm e Ministrisë së Rendit Publik hetoi vetëm 12 raste të përfshirjes së policisë në të gjitha format e trafikimit.

Shërbimet qeveritare ofruar viktimave të trafikimit mbetën shumë të kufizuara; megjithatë, disa OJQ ishin aktive në trajtimin e nevojave të fëmijëve. IOM drejtonte një qendër riintegrimi në Tiranë që ofronte këshillim dhe shërbime mjekësore, trainim për punë, dhe njëfarë asistence ligjore. Streha Vatra, një OJQ në Vlorë, ofronte shërbime të ngjashme. Të dyja strehat raportuan që një përqindje e madhe e rasteve të tyre në vitin 2003 dhe gjatë vitit kishin të bënin me viktima të riatdhesuara në vend nga vende të tjera europiane.

IOM gjithashtu pati pesë raste përkujdesjeje të përkohshme të lidhura me trafikimin e personave gjatë vitit.

Trajtimi nga policia i grave të trafikuara vazhdoi të përmirësohej gjatë vitit. Shumica e punonjësve të policisë pushoi së trajtuari gratë e trafikuara si kriminele në vend të viktimave dhe në mënyrë rutinë ia referonte ato OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare për asistencë. Femra të huaja që ndaloheshin hera herës nuk kishin shërbime përkthimi ose nuk u jepej mundësi zgjedhje për avokatë.

Me kontribut domethënës nga bashkësia e OJQ-ve, Qeveria përgatiti një Memorandum Mirëkuptimi në prill për t'u nënshkruar me Greqinë në lidhje me riatdhesimin e viktimave të trafikimit të fëmijëve. Qeveria Greke nuk e pati nënshkruar marrëveshjen deri në fund të vitit.

Viktimat e trafikimit shpesh përballeshin me stigmatizim të konsiderueshëm nga familjet e tyre dhe shoqëria. Sipas Strehës Vatra, ka pasur shumë raste ku viktima të trafikimit, përfshi edhe minorenët, janë kërcënuar me vdekje prej familjeve të tyre për shkak të së shkuarës së tyre. Shërbimet qeveritare në dispozicion të viktimave të trafikimit mbetën të kufizuara. Ritrafikimi u bë një problem i rëndësishëm, me 141 nga 291 viktima të strehuara në Strehën Vatra gjatë vitit që raportuan se kishin qenë trafikuar të paktën dy herë më parë dhe shtatë prej viktimave ishin nën kërcënime të vazhdueshme nga keqbërësit.

Gjatë vitit, Qeveria përgatiti një strategji kombëtare për të luftuar trafikimin e fëmijëve; kjo priste miratim nga Këshilli i Ministrave deri në fund të vitit.

Qendra Antitrafikim e Vlorës, e cila u hap në vitin 2001, nuk ishte plotësisht në funksionim, megjithëse ishte përdorur si pikë komandimi për operacionet Mirazh. OJQ kombëtare dhe ndërkombëtare kryen pjesën më të madhe të fushatave për ndërgjegjësim mbi trafikimin.

Personat me Paaftësi

Pati një nivel diskriminimi kundër personave me paaftësi në punësim, arsimim, akses ndaj kujdesit shëndetësor dhe sigurimin e shërbimeve të tjera shtetërore. Varfëria e përhapur gjerësisht, kushtet e pasistemuara të punës, si dhe kujdesi i ulët shëndetësor paraqitën probleme të rëndësishme për shumë persona me paaftësi. Ata kishin të drejtën të kenë forma të ndryshme asistence publike; megjithatë, kufizimet buxhetore kufizuan shumë sasinë e shumave që ata morën faktikisht. Nuk ka ndonjë ligj që të detyrojë aksesin e personave me paaftësi në ndërtesat publike, dhe në këtë drejtim u bë pak.

Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Mbrojtjet kushtetuese kundër diskriminimit zbatohen kundrejt të gjitha pakicave; megjithatë, diskriminimi shoqëror kundër anëtarëve të popullsive të pakicave mbeti, sidomos ndaj anëtarëve të bashkësive rome dhe egjiptiane. Në mars, Këshilli i Ministrave ngriti Komitetin Shtetëror për Pakicat. Komiteti raportonte dhe përfaqësonte interesat e të gjitha pakicave kundrejt Qeverisë. Komiteti përbëhet nga përfaqësues prej pakicave të ndryshme kombëtare dhe etnike-gjuhësore.

Sipas Zyrës së Çështjeve të Pakicave, për t'u kualifikuar për statusin e pakicës kombëtare apo etno-gjuhësore, një grup individësh duhet: të ndajë të njëjtën gjuhë (të ndryshme nga shqipja), të ketë dokumentacion për të provuar origjinën e vet të dallueshme apo identitetin kombëtar, të ketë zakone dhe tradita të dallueshme, apo një lidhje me një shtet të afërm jashtë vendit. Për shembull, grupit të njohur si egjyptian nuk iu dha statusi i pakicës sepse u mungonin disa kritere, të tilla si një gjuhë e dallueshme dhe traditat, të cilat mund t'i përkufizonin si pakicë. Në vend të kësaj, egjyptianëve iu referohej me emrin bashkësi.

Grekët janë pakica më e madhe kombëtare, ndjekur nga grupe të vogla maqedonësish dhe malazezësh; arumunët (vllehët) dhe romët përkufizohen si grupe pakicash etno-gjuhësore.

Pakica greke etnike, udhëhequr nga shoqata e saj kulturore Omonia, ndoqi në mënyrë kolektive ankesat ndaj Qeverisë në lidhje me zonat zgjedhore, arsimin në gjuhën greke, të drejtat e pronës

dhe dokumentat qeveritare. Udhëheqësit e pakicës u ankuan për mosgatishmërinë e Qeverisë për të njohur ekzistencën e mundshme të qyteteve etnike greke jashtë "zonave minoritare" të periudhës komuniste; për të përdorur greqishten në dokumente zyrtare dhe në tabelat publike në zonat etnike greke; për të përcaktuar përmasat e popullsisë greke etnike; dhe për të përfshirë një numër më të madh grekësh etnikë në administratën publike.

Shkollat fillore publike në gjuhën greke ishin të zakonshme në pjesën më të madhe jugore të vendit, ku jetonin shumica e grekëve etnikë. Çdo fshat në këtë zonë kishte shkollën e vet fillore-nëntëvjeçare në gjuhën greke, pavarësisht nga numri i nxënësve dhe Gjirokastra kishte dy shkolla të mesme. Megjithatë Omonia tha se grekët etnikë kishin nevojë për më shumë mësim brenda dhe jashtë të ashtuquajturave zona të minoritetit. Zyra e Çështjeve të Pakicave theksoi që Qeveria kurrë nuk ka mbyllur një shkollë apo klassë edhe kur numri i nxënësve ishte pakësuar si rezultat i kalimit në klasa më të larta, migrimit apo faktorëve të tjerë. Në vitin 2003, Kuvendi miratoi një amendament që riautorizonte përfshirjen e kombësisë/etnisë në Regjistrin Civil dhe identifikimin e brendshëm, çka pritej të lehtësonte vështirësinë për vërtetimin e etnisë për kërkesa të ardhshme për shkolla në gjuhën e pakicave.

Bashkësitë rome dhe egjyptiane ishin mes grupeve më të neglizhuara politikisht, ekonomikisht dhe shoqërisht në vend. Pati raportime që policia rrahu romë dhe egjyptianë gjatë vitit (shih Seksioni 1.c.). Pati gjithashtu raportime që familje rome dhe egjyptiane u zhvendosën nga policia nga strehimi i përkohshëm. Në qershor, 51 familje rome u detyruan të largoheshin nga mjediset e tyre të banimit (shih Seksioni 1.f.).

Anëtarë të bashkësisë egjyptiane kishin tendencën të vendoseshin në zona urbane dhe përgjithësisht ishin më të integruar në shoqëri se sa romët. Përveç diskriminimit të shumëpërhapur shoqëror, këto grupe përgjithësisht vuanin nga analfabetizmi i lartë, sidomos mes fëmijëve, kushte të këqija shëndetësore, mungesë shkollimi, si dhe disavantazhe të theksuara ekonomike. Qeveria i njihte zyrtarisht romët si një pakicë më shumë etno-gjuhësore se sa kombëtare. Deri në fund të vitit, Qeveria nuk e kishte zbatuar Strategjinë e saj Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës për Pakicën Rome. Pavarësisht nga mohime të përsëritura, bashkësia egjyptiane vazhdoi të përpiqej të fitonte statusin e pakicës nga Qeveria.

Në vitin 2003, GSHDNJ pohoi se policia kishte vënë në shënjestër bashkësinë homoseksuale. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Gay Albania, policia shpesh kishte arrestuar në mënyrë arbitrare homoseksualët dhe pastaj i kishte abuzuar ata fizikisht dhe verbalisht gjatë kohës kur këta ishin të ndaluar. Megjithatë, policia i mohoi këto akuza dhe deklaroi që kur ishin arrestuar homoseksualët, kjo kishte ndodhur për shkelje të ligjit – si për shembull prishja e qetësisë – dhe jo për shkak të preferencave të tyre seksuale.

Seksioni 6 Të Drejtat e Punëtorëve

a. E Drejta e Shoqatës

Punëtorët kishin të drejtën të formojnë sindikata të pavarura dhe punëtorët e ushtronin këtë të drejtë në praktikë, megjithatë punonjësit e Qeverisë ndalohen të bashkohen në sindikata apo të zhvillojnë greva. Dy federata të mëdha vepronin si organizata ombrellë për shumicën e

sindikatave të vendit: Konfederata e Pavarur e Sindikatave të Shqipërisë (me anëtarësi rreth 85,000) dhe Konfederata Shqiptare e Sindikatave (me anëtarësi rreth 100,000). Të dyja organizatat përsëri përjetuan një rënie të anëtarësisë gjatë vitit për shkak të papunësisë dhe pakënaqësisë së punëtorëve me sindikatat. Disa sindikata vendosin të mos bashkohen me asnjë prej federatave. Asnjë sindikatë nuk ka ndonjë përkatësi zyrtare politike, dhe Qeveria nuk ofroi ndonjë mbështetje financiare për sindikatat.

Ligji nuk ndalon diskriminimin antisindikatë; megjithatë, nuk pati raportime për diskriminim të tillë në praktikë.

Sindikatat ishin të lira të vendosin dhe të mbanin lidhje me organizata ndërkombëtare.

b. E Drejta për t'u Organizuar dhe Negociuar Kolektivisht

Qytetarët në të gjitha fushat e punësimit, me përjashtim të anëtarëve me uniformë të forcave të armatosura, oficerëve të policisë, si dhe disa nëpunës gjykatash, kanë të drejtën kushtetuese për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht dhe Kodi i Punës përcakton procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve të negociimit kolektiv; megjithatë, sindikatat operonin nga pozita të dobëta. Në praktikë, sindikatat që përfaqësojnë punonjësit e sektorit publik negocionin drejtpërdrejt me Qeverinë. Negociimi i efektshëm kolektiv mbeti i vështirë dhe marrëveshjet ishte e vështirë të zbatoheshin.

Kushtetuta dhe legjislacioni tjetër sigurojnë që të gjithë punëtorët, me përjashtim të punonjësve civilë, përfshi ushtarakët me uniformë, policinë dhe disa zyrtarë të gjykatave, kanë të drejtën të bëjnë grevë. Ligji ndalon grevat që deklarohen haptas të jenë politike ose që gjykohen nga gjykatat si politike.

Në janar, punëtorët e një fabrike ferro-kromi në Burrel zhvilluan një grevë urie 12-ditore për të protestuar kundër mospagimit të pagave të tyre. Pas ndërhyrjes së sindikatës, fabrika ua pagoi pagat e prapambetura punëtorëve në grevë.

Në prill, 10 punëtorë të Parkut të Transportit Urban në Tiranë zhvilluan një grevë urie 5-ditore për të protestuar kundër shkarkimeve të jashtëligjshme. Drejtori i Parkut pohoi që greva e tyre shkelte kontratën e punësimit. Megjithatë, GSHDNJ dhe Avokati i Popullit deklaruan që greva e urisë ishte e ligjshme dhe që Drejtori i Parkut nuk i ishte përmbajtur Kodit të Punës në rastin e pushimit të punëtorëve. Greva zgjati 5 ditë. Deri në fund të vitit, punëtorët nuk ishin rimarrë në punë.

c. Ndalimi i Punës së Detyruar

Kushtetuta dhe Kodi i Punës ndalojnë punën e detyruar, përfshi nga fëmijët; megjithatë, praktika të tilla ndodhën (shih Seksionet 5, Trafikimi dhe 6.d.).

Ndalimi i Punës së Fëmijëve dhe Mosha Minimale për Punësim

Kodi i Punës e përcakton moshën minimale të punësimit në 14 vjeç dhe kufizon masën dhe llojin e punës që mund të kryhet nga fëmijë nën moshën 16 vjeç. Fëmijët midis moshave 14 dhe 16 vjeç ligjërisht mund të punojnë në punë me kohë të pjesshme gjatë pushimeve të verës. Ministria e Punës mund të zbatojë kërkesat mbi moshën minimale përmes gjykatave; megjithatë, nuk pati raportime për zbatim të tillë. Inspektime të punës në fabrika kryer gjatë gjysmës së parë të vitit gjetën se vetëm 0.01 përqind e punëtorëve ishin nën moshë. Shumica e fabrikave të inspektuara ishin kompani këpucësh dhe tekstilesh. Më shumë se 70 përqind e punëtorëve nën moshë ishin vajza. Gjoba për punësimin e një punëtori nën moshë ishte normalisht 20 deri 30 herë më e lartë se sa paga minimale mujore e punëtorit. CRCA vlerësonte se afro 50,000 fëmijë nën moshën 18 vjeç punojnë me orë të plota ose të pjesshme. Ligji ndalon punën me forcë apo të detyruar të fëmijëve; megjithatë, pati raportime që praktika të tilla ndodhën. OJQ-të raportuan që inspektorët e punës, të cilët janë përgjegjës për hetimin e ankesave për punë të fëmijëve, nuk dhanë gjoba, ndëshkime apo dënime për ata që dhunojnë ligjet mbi punën e fëmijëve. UNICEF vlerësonte se 23 përqind e fëmijëve në moshat nga 5 deri 14 vjeç në vend punonin gjatë periudhës 1999 deri 2003. fëmijët që konsideroheshin se punonin përfshinin ata që kanë kryer çfarëdo pune të paguar apo të papaguar për dikë që nuk është anëtar i shtëpisë, që kanë kryer më shumë se sa 4 orë punë shtëpie në familje, apo që kanë kryer punë të tjera në shtëpi. OJQ-të raportuan që inspektorët e punës, të cilët kishin për detyrë të hetonin ankesa për punë të fëmijëve, nuk kishin vënë gjoba, ndëshkime, apo ndjekje për ata që kishin shkelur ligjet mbi punën e fëmijëve.

Kishte fëmijë që punonin, disa deri edhe 16 orë në ditë. Sipas CRCA, shumica e fëmijëve punëtorë punonin si shitës rruge apo dyqanesh, lypës, fermerë apo barinj, shpërndarës droge, larës makinash, punëtorë fabrikash tekstile, llustraxhinj, apo prostituta; megjithatë, në Tiranë dhe qytete të tjera, fëmijët – kryesisht romë – punonin si lypës ose shisnin cigare dhe artikuj të tjerë në rrugë; në përgjithësi, policia e injoronte këtë praktikë. CRCA gjithashtu vërejti që kishte afërsisht 800 fëmijë rrugësh në Tiranë. Numra në rritje fëmijësh në Tiranë ranë viktima të prostitucionit dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Pati raportime që fëmijë u trafikuan për qëllime pune të detyruar (shih Seksioni 5, Trafikimi).

e. Kushtet e Pranueshme të Punës

Paga ligjore minimale për të gjithë punëtorët mbi moshën 16 vjeç ishte afërsisht 110 dollarë (10,800 lekë) në muaj, çka nuk mjafton për të siguruar një nivel të përshtatshëm jetese për një punëtor dhe një familje. Dërgesat prej atyre që punojnë jashtë ishin shumë të rëndësishme për shumë familje. Ligji parashikon asistencë sociale (mbështetje të ardhurash) dhe kompensim për papunësinë, por këto ishin shumë të kufizuara, si për nga shuma e marrë ashtu dhe nga numri i personave të mbuluar faktikisht. Paga mesatare për punëtorët në sektorin publik ishte afërsisht $217 (21,325 lekë) në muaj. Afërsisht 25 përqind e popullsisë jetonte nën nivelin zyrtar të varfërisë.

Kodi i Punës përcakton një javë pune prej 40 orësh; megjithatë, në praktikë, orët në mënyrë tipike përcaktoheshin nga marrëveshje individuale apo kolektive. Shumë persona punonin 6 ditë në javë. Me ligj, duhet dhënë pagesë jashtë orarit dhe kishte periudha të detyruara pushimi; megjithatë, këto dispozita nuk zbatoheshin gjithmonë në praktikë.

Qeveria përcaktoi standartet shëndetësore dhe të sigurisë në punë; megjithatë, kishte fonde të kufizuara për të bërë përmirësime në ndërmarrjet shtetërore të mbetura dhe aftësi të kufizuar për të zbatuar standartet në sektorin privat. Kushtet faktike në vendin e punës ishin përgjithësisht shumë të këqia dhe shpesh të rrezikshme. Gjatë vitit, në shtyp u raportuan një numër vdekjesh në lidhje me punën, veçanërisht në industrinë e ndërtimit dhe minierave. Kodi i Punës radhit detyrimet e punëdhënësve dhe të punësuarve për sigurinë por nuk u jep punëtorëve të drejtën të lënë një vend pune të rrezikshëm, pa u kërcënuar atyre vazhdimin e punësimit. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ishte përgjegjëse për vënien në zbatim të rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë; megjithatë, këto rregullore përgjithësisht nuk zbatoheshin në praktikë.